



REPUBLIC OF KOSOVO	
31.07.2024	
Njësi Udhëheqëse Organi	Posta Poste
01-351-24079/24	

## Marrëveshje Bashkëfinancimi

në mes të

### Advancing Together dhe Komunës së Klinës

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit, të nënshkruar në mes Komunës së Klinës dhe OJQ Advancing Together me datë 27. 09. 2023, protokoluar me Nr. 300-33996703.

Me këtë dokument- Marrëveshje, Komuna e Klinës konfirmon se mbështetë plotësisht OJQ-në "Advancing Together", e cila është zbatuese e projektit "Bëhu Partneri im Për Mirëqenje" i financuar nga UNMIK.

Përkitazi me këtë, Komuna e Klinës zotohet se do të bashkëfinancojë projektin: Pajisja e shkollës fillore 'Nënë Tereza' Budisalc/Budisavc me unaze dhe mbajtese basketbolli si dhe mbulese per dru zjarrit.

Marrëveshja bëhet për projektin e paraqitur për të cilin Komuna e Klinës konsideron se do të kontribuojnë në ndërtimin e besimit dhe ndërveprimit mes të gjitha komuniteteve që jetojnë në këtë Komunë.

Afati i zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit është jo më larg se në fund të muajit Gusht 2024.

#### Obligimi i palëve:

- OJQ "Advancing Together" do të financojë projektin në vlerë prej 2,900.00€ (dy mijë e nëntqind euro).
- Komuna e Klinës do të marrë pjesë me shumën prej 1,000.00€ (një mijë mijë euro ), e cila do të transferohet në llogarinë bankare të OJQ-së "Advancing Together" ProCredit Bank 1189-006005-0001-58 jo më vonë se 25 korrik, 2024.

#### Interpretimi dhe Ndryshimi

Interpretimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëfinancimit do të bëhet në pajtim me ligjet e Kosovës duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshje të Bashkëfinancimit mund të bëhen vetëm me shkrim të nënshkruara nga ana e të dy palëve.

### Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje të bashkëfinancimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësive në tekstin e kësaj Marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, e në rast se kjo nuk arrihet, kompetente do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë.

### Shkëputja e Marrëveshjes

E drejta e shkëputjes së njëanshme të kësaj Marrëveshje të bashkëfinancimit, do të bëhet në rastet e shkeljeve të obligimeve që janë të përcaktuara me këtë Marrëveshje të bashkëfinancimit, duke e njoftuar palën tjetër 30 (tridhjetë) ditë para shkëputjes së Marrëveshjes.

### Hyrja në Fuqi

Kjo marrëveshje e Bashkëfinancimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

### Projekti:

1/ Pajisja e shkollës fillore 'Nënë Tereza' Budisalc/Budisavc me unaze dhe mbajtese basketbolli si dhe mbulese per dru zjarrit..

Buxheti total për projekt	-----€ 3,900.00
Financimi nga Advancing Together	----- € 2,900.00
Financimi nga Komuna	----- € 1,000.00

**Advancing Together**  
Drejtor Ekzekutiv

Bashkim Ibishi



**Komuna e Klinës**  
Kryetar i Komunës

Zenun Elezaj

